



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**LEGJISLATURA VI**

*Sesioni pranveror*

**Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim**

Mbledhja nr.19

Prishtinë, më 20.6.2018, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Igor Simiq, kryetar i Komisionit, Danush Ademi zëvendëskryetarë, Kujtim Shala, Fadil Beka, Zoran Mojsilović, Jasmina Zhivković, Sasha Milosavljević, Rasim Selmanaj, Albert Kinolli, Mufera Serbica- Shinik, Duda Balje, Slobodan Petrović dhe Veton Berisha, anëtarë.

**Mungoi:** Xhelal Sveçla, anëtarë .

Pjesëmarrësit tjerë: përfaqësues të OSBE-së Senad Karaahmetović dhe Smajl Demaj; përfaqësues të KDI-së Artan Murati dhe Riza Nushi. këshilltar i Sekretariatit të KKK-së Zijush Ahmeti, dhe Celal Iliaz, Drejtorja për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Nga stafi mbështetës të komisionit: Natasha Prica- Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Igor Simiq, kryetar i Komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 14.05.2018, 22.05.2018 dhe 5.06.2018;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-042 për gjak dhe përbërësit e gjakut dhe amendamentet e Komisionit Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës dhe amendamentet e Komisionit Funkcional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-038 për Shërbimet Postare dhe amendamentet e Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal;
6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-040 për Masat Mbrojtëse në Importe dhe amendamentet e Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal;
7. Shqyrtimi i Projektkodit nr.06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur dhe amendamentet e Komisionit Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;

8. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-010 për Noterinë dhe amendamentet e Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;**
9. **Të ndryshme.**

1. **Miratimi i rendit të ditës.**

*Kryetari, konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

2. **Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 14.5.2018, 22.5.2018 dhe 5.6.2018;**

**Kryetari** konstatoi se procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 14.5.2018, 22.5.2018 dhe 5.6.2018, u miratuan njëzëri.

3. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-042 për gjak dhe përbërësit e gjakut dhe amendamentet e Komisionit FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;**

**Kryetari**, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 06/L-042 për gjak dhe përbërësit e gjakut, dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL.

**Fadil Beka**, pati disa vërejtje në raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL, mirëpo, pasi ishte vonuar në dhënien e amendamenteve me kohë, ai tha se propozimet e tij do ti paraqesë në Seancë Plenare.

*Pas diskutimeve, kryetari konstatoi se Komisioni i miratoi të njëjtat me 9 (nëntë) vota Për dhe 4 (katër) Abstenime, dhe nxori këtë:*

#### **Rekomandim**

Projektligji nr. 06/L-042 për gjak dhe përbërësit e gjakut dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL, nuk cenon dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend.

4. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës dhe amendamentet e Komisionit FunkSIONAL për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi;**

*Kryetari hodhi në votim Projektligjin me Raport amendamente të Komisionit FunkSIONAL, dhe konstatoi se Komisioni miratoi të njëjtat me 9 (nëntë) vota Për dhe 4 (katër) Abstenime, dhe nxori këtë:*

#### **Rekomandim**

Komisioni konstatoi se Projektligji nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL nuk cenon dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend.

**5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-038 për Shërbimet Postare dhe amendamentet e Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal;**

*Kryetari hodhi në votim Projektligjin me Raport dhe amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, dhe konstatoi se Komisioni i miratoi të njëjtat me 9 (nëntë) vota Për, 4 (katër) Abstenime, dhe nxori këtë:*

**Rekomandim**

Komisioni konstatoi se Projektligji nr.06/L-038 për Shërbimet Postare dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend.

**6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-040 për Masat Mbrojtëse në Importe dhe amendamentet e Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal;**

**Kryetari**, tha se ky projektligj me raport amendamente nuk është i hartuar mirë. Ai u ndërlidh me temën se bëhet fjalë për ndalimin e importimit të disa mallrave deri në 85% , që në një farë mënyre rrezikon ekonominë në Kosovë, për çka nuk është dakord edhe Lista Serbe, ngase kërkojmë nga Qeveria të bëjë politikë të mirëfilltë, me arsye që t'ju mundësohet prodhuesve një ekonomi më stabile e jo të pengohen.

*Pas diskutimeve, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, nxori këtë:*

**Rekomandim**

- I. Komisioni me shumicë të votave , 9 Për dhe 4 Kundër, konstatoi se Projektligjit nr.06/L-040 për Masa Mbrojtëse në Importe dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL nuk cenon dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, kështu që rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend.
- II. Përfaqësuesit e Grupit Parlamentar të Listës Serbe në strukturën e komisionit janë deklaruar kundër miratimit të Projektligjit dhe amendamenteve të propozuara, me konstatim se prekin dhe cenon të drejtat dhe interesat e komunitetit serb.

**7. Shqyrtimi i Projektkodit nr.06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur dhe amendamentet e Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;**

*Kryetari hodhi në votim Projektligjin me Raport amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, dhe konstatoi se Komisioni i miratoi të njëjtat me 9 (nëntë) vota Për dhe 4 (katër) Abstenime, dhe nxori këtë:*

**Rekomandim**

Komisioni konstatoi se Projektkodit nr.06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL, nuk cenon dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend.

## **8. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-010 për Noterinë dhe amendamentet e Komisionit Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;**

**Kryetari**, unë jam anëtar edhe në Komisionin për Legjislacion, dhe jam në rrjedha si janë zhvilluar procedurat gjatë shqyrtimit të këtij projektligji. Mes tjerash, ai tha se Lista Serbe dhe G6+ kanë dhënë nga katër amendamente dhe të njëjtat nuk janë miratuar nga Komisioni Funkcional. Ai diskutoi lidhur me amendamentet e dhëna nga LS-ja, ku kemi propozuar që dokumentet e noterisë publike të lëshohen në gjuhën shqipe dhe serbe, si gjuhë të barabarta, në përputhje me Kushtetutën, për çka ne nuk pajtohemi se është përkrah amendamenti, me ç'rast lëshohen dokumentet noteriale në gjuhën angleze. Në amendamentin e dytë, kemi kërkuar që shpallja e konkursit për noter të publikohet në njërin nga mediat ku interpretohet programi në gjuhën serbe. Me amendament tjetër, kemi kërkuar që në Komisionin ku jepet provimi i noterisë të respektohet etniteti gjithëpërfshirës në Kosovë. Ai konstatoi se nuk janë përkrahë amendamentet e LS-së nga ana e Komisionit Funkcional dhe për këtë arsye, ne do të votojmë kundër miratimit të këtij projektligji.

*Pas diskutimeve, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, nxori këtë:*

### **Rekomandim**

- I. Komisioni me shumicë të votave , 7 Për, 4 Kundër dhe 2 Abstenime, konstatoi se Projektligji nr.06/L-010 për Noterinë dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional, nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, kështu që rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend.
- II. Përfaqësuesit e Grupit Parlamentar të Listës Serbe, në strukturën e komisionit janë deklaruar kundër miratimit të këtij Projektligji dhe amendamenteve të propozuara, me konstatim se prekin dhe cenojnë të drejtat dhe interesat e komunitetit serb.

## **9. Të ndryshme.**

Në këtë pikë nuk pati diskutime.

*Mbledhja përfundoi në orën 10:45.*

*E përgatiti stafi mbështetës i Komisionit*

**Kryetar i komisionit,  
Igor Simiq**